

AKT THEMELIMI

SHOQËRIA TREGTARE

“ Gjaberi 2001 construction”

Sh.p.k

TIRANË / SHQIPËRI

DATË 12.01.2024

Sot, në Tiranë, më datë 06.01.2024 Z. Servet Gjaberi lindur me 08.12.1974, lindur ne Bushtricë dhe banues ne Rruga"Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjofimit-elektroni, Nr. Personal H41208071B , harton akt themelimin dhe statutin e shoqërisë “Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.si më poshtë vijon:

NENI 1 FORMA

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (**SH.P.K**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në vecanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, si dhe me përcaktimet e këtij statuti.

NENI 2 EMRI

1. Emri i shoqërisë është **"Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.**
2. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT.

NENI 3 ORTAKËT

1. Shoqëria **"Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.** është shoqëri me 1 (një) ortakë.
2. Ortaku e shoqërisë **"Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.** është :
 1. **Z. Servet Gjaberi lindur me 08.12.1974, lindur ne Bushtricë dhe banues ne Rruga "Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal H41208071B.**
3. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetë të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas rregullave/procedurave të këtij statuti dhe/ose dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak.
4. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 4 SELIA

1. Selia e shoqërisë **" Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.** ndodhet me adresë: **Rruga "Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, Shqipëri.**
2. Trasferimi i selisë së shoqërisë **" Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.** në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Shoqëria **" Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k.** mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

NENI 5 OBJEKTI

1. Shoqëria **"Gjaberi 2001 construction" Sh.p.k** ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar:

- a. Sherbime ne fushen e ndertimit, import-eksport te gjithë mallrave, tregti te materialeve te ndertimit, ndertim te objekteve te karakterit civil dhe industrial te te gjitha llojeve, ndertim i rrugeve, trotuareve, pritave, digave si dhe sherbime per mirembajtjen e tyre. Import-eksport, tregtim me pakice dhe shumice, prodhim, transport e tregtim te materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem, ushqimore, makineri e pjese kembimi, pajisje elektrike, elektronike, hidraulike, lende te para, materiale ndertimi, inerte, produkte te gatshme e gjysem te gatshme, konfeksione, duralumin, xhelateri, agjensi publicitare dhe imobiliare.

NENI 6 KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** është e pakufizuar.
2. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** fillon nga data e regjistrimi në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

NENI 7 KAPITALI

1. Kapitali bazë i shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** është 50 000 (pesëdhjetemijë) lek qe do te paguhet nga ortakët e shoqërisë sipas pjesmarrjes në kapital e shoqërisë.
2. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themeltarë dhe të regjistruar të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**
3. Kapitali shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, ndahet në 1 kuote dhe cdo kuota ka vlerën e 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITAL

1. Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si më poshtë vijon:
 - a) **Z.Servet Gjaberi zotëron 100% kapitalin e shoqërisë, 1 (nje) kuote me vlere 50 000 leke.**
2. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Administratori dhe sipas nevojës mund të marri vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrin të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim.
4. Çertifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci.
5. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortakut/ët e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**

NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, janë si më poshtë vijon:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Adminstratori/et.

NENI 10 ADMINISTRIMI

1. Shoqëria **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.** administrohet nga administratori **Z. Servet Gjabetri lindur me 08.12.1974 , lindur ne Bushtrice dhe banues ne Rruga"Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal H41208071B.**
2. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
3. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
5. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.
6. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me këtë statut:
 - a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
7. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
8. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.
9. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri,

- përpara datës në të cilën doreheqja të hyje në fuqi.
10. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëhere administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
 11. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.
 12. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji.

NENI 11 PËRFAQËSIMI

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare" i ndryshuar.
2. Administratoriët, që përfaqësonjnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
3. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.
4. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
5. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
6. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
7. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. numrin unik të identifikimit;
 - b. formën ligjore të shoqërisë;
 - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - e. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 12

Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi.

THEMELUESIT I SHOQËRISË
“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.
Z. Servet Gjaberi

STATUTI

SHOQËRIA TREGTARE

“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.

TIRANË / SHQIPËRI

DATË 12.01.2024

Sot, në Tiranë, më datë 06.01.2024 Z. Servet Gjaberi lindur me 08.12.1974, lindur ne Bushtrice dhe banues ne Rruga "Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjofimit-elektroni, Nr. Personal H41208071B:

hartojmë statutin e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction”** Sh.p.k.si më poshtë vijon:

KREU I
THEMELIMI, EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, REGJISTRIMI, REGJIMI, ORTAKËT
DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 1 THEMELIMI

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në vecanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, si dhe me përcaktimet e këtij statuti.

NENI 2 EMËRTIMI

1. Emri i shoqërisë është **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**
2. Shoqëria mund të përdor edhe emërtimin e saj tregtar **“Gjaberi 2001 construction”**.
3. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT.

NENI 3 SELIA

1. Selia e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** ndodhet me adresë: **Rruga "Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez**
2. Trasferimi i selisë së shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm) dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Shoqëria **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

NENI 4 OBJEKTI

1. Shoqëria **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar:
 - a. Sherbime ne fushen e ndertimit, import-eksport te gjithe mallrave, tregti te materialeve te ndertimit, ndertim te objekteve te karakterit civil dhe industrial te te gjitha llojeve, ndertim i rrugeve, trotuareve, pritave, digave si dhe sherbime per mirembajtjen e tyre. Import-eksport, tregtim me pakice dhe shumice, prodhim, transport e tregtim te materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem, ushqimore, makineri e pjese kembimi, pajisje elektrike, elektronike,

hidraulike, lende te para, materiale ndertimi, inerte, produkte te gatshme e gjysem te gatshme, konfeksione, duralumin, xhelateri, agjensi publicitare dhe imobiliare.

NENI 5 REGJISTRIMI

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.** formohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (**SH.P.K**) në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Gjabetri 2001 construction.2007** "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" i ndryshuar.
3. Shoqëria **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.** duhet të regjistrojë dhe të arkivojë dokumentet në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" i ndryshuar si dhe me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
4. Nëse shoqëria **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.**, do të ketë faqen e saj interneti të dhënat e nevojshme që do ti njoftohen QKB-në për regjistrim do të publikohen dhe do ti vihen në dispozicion edhe personave të tretë të interesuar.

NENI 6 REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

1. Shoqëria **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.** udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut të lirë, me objektiv për të nxjerrë fitim.
2. Aktiviteti i saj bazohet në statutin dhe në aktin e themelimit të shoqërisë, si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
3. Shoqëria ka personalitet juridik i cili fillon që nga data e regjistrimit në Qendrë Kombëtare të Biznesit (QKB).

NENI 7 ORTAKËT E SHOQËRISË

1. Shoqëria **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.**, është shoqëri me 1 (nje) ortak.
2. Ortaku i shoqërisë **“Gjabetri 2001 construction” Sh.p.k.**, është :
3. **Z. Servet Gjabetri lindur me 08.12.1974 lindur ne Bushtrice dhe banues ne Rruga"Banka Boterore", Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal H41208071B.**
4. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetë të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas rregullave/procedurave të këtij statuti dhe/ose dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak.
5. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëhere ortakut i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortakut i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëhere ortakut përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 8 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, është e pakufizuar.
2. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 9 KAPITALI

1. Kapitali bazë i shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, është 50 000 (pesëdhjetemijë) lek që do të paguhet nga ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjes në kapital të shoqërisë.
2. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themelues dhe të regjistruar të shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**
3. Kapitali i shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, ndahet në 1 kuota dhe çdo kuota ka vlerën e 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 10 KONTRIBUTET NË KAPITAL BAZË

1. Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si më poshtë vijon:
 - a) **Z.Servet Gjaberi zotëron 100% kapitalin e shoqërisë, 1 (nje) kuote me vlere 50 000 leke.**
2. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Administratori dhe sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrimit të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim.
4. Çertifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci.
5. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themelues, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortakët e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**

NENI 11 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT BAZË

1. Pjesët e kapitalit bazë/kuotat, mund të transferohen lirisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me përcaktimet e këtij statuti.
2. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga miratimi i Asamblesë së Përgjithshme si dhe nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim.
4. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 5 të këtij neni.
5. Shoqëria duhet të regjistrojë transferimin e kuotave në përputhje me ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendra Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.
6. Regjistrimi i transferimit të kuotave ka një efekt deklarativ.

NENI 12 ABUZIMI I ORTAKËVE

1. Ortaku dhe/ose ortakët e shoqërisë, që kryejnë një ose më shumë prej veprimeve të mëposhtme, janë personalisht përgjegjës për detyrimet e shoqërisë, me të gjitha pasuritë e tyre:
 - a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
 - b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
 - c) nuk njoftojnë në kohë problemet e shoqërisë (si, njoftimet mbi aftësinë paguese të shoqërisë ose të gjitha problemet e tjera që rrezikojnë atë, etj).

NENI 13 NDALIMI I KONKURRENCËS DHE SEKRETI TREGTAR

1. Ortakët nuk mund të mbajnë pozicione drejtuese apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik që ushtrojnë me këtë shoqëri në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Ndalimi i përmendur me sipër mund të anulohet në vijim të një autorizimi të lëshuar nga Asambleja e Përgjithshme me 3/4 e votave të ortakëve.
3. Nëse një nga ortakët dhunon ndalimin e konkurrencës, shoqëria, ka të drejtë:
 - a. ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
 - b. të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
 - c. të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
 - d. Etj sipas ligjit në fuqi.
3. Të gjithë personat e kësaj shoqërie, të cilët janë në dijeni të sekretit tregtar të kësaj shoqërie janë personalisht përgjegjës për ruajtjen e tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Zbatueshmëria e përcaktimeve të këtij neni është në përpjestim të drejtë dhe për aq sa lidhet me faktin e shoqërisë me ortak të vetëm.

NENI 14 SHKARKIM I ORTAKTUT TË SHOQËRISË

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit. Administratori duhet të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, mbasi ka

- marrë lajmërimin e thene më sipër, për të vendosur nëse kuota e këtij ortaku do të likujdohet, për shkak të largimit të tij nga shoqëria.
3. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
 4. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara.
 5. Zbatueshmëria e këtij neni do të lidhet me kohën kur shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

NENI 15 PËRJASHTIMI I NJË ORTAKU

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:
 - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut, ose;
 - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Shoqëria, ka të drejtë ti kërkojë ortakut të përjashtuar, dëmshpërblimin e dëmeve që ka pasur nga veprimet që kanë shkaktuar përjashtimin.
4. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
5. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.
6. Zbatueshmëria e këtij neni do të lidhet me kohën kur shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

NENI 16 SHPËRNDARJA, KUFIZIM I SHPËRNDARJES DHE CERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE

1. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë merr vendim për shpërndarjen e fitimeve në përputhje me përcaktimet e këtij statuti dhe/ose ligjit në fuqi.
2. Përfitimet e shoqërisë ndahen sipas bilanceve financiare të shoqërisë.
3. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim
4. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
5. Ortaku, që ka marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendit, që ka shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese,

ose kur ka pasur dijeni ndaj paaftësisë paguese të shoqërisë

NENI 17 ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

1. Shoqëria ka të drejtë për të anuluar një kuotë.
2. Shkaqet si dhe procedurat e anulimit dhe likuidimit të kuotës parashikohen në vendimi e marrë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
3. Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e saj sipas pikës 2 të këtij neni.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË

NENI 18 ORGANET E SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.**, janë si më poshtë vijon:
 - c) Asambleja e Përgjithshme;
 - d) Administratori/ët.
2. Ky statut apo çdo vendim i shoqërisë nuk mund të ndryshojë apo të kufizojë kompetencat që ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar përcakton për organet e shoqërisë **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Dalohet delegimi i detyrave, përgjegjësisive dhe kompetencave të organve të shoqërisë një organi tjetër të shoqërisë.

NENI 19 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) transferimin e kuotave të shoqërisë;
 - d) emërimin e shkarkimin e administratorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tij;
 - e) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - f) përcaktimin e shpërblimeve të likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël;
 - g) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - l) shpërndarjen e fitimeve;
 - m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

2. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
3. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionale të veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
5. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 20 MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga administratori/ët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligjit Nr. 9901, data 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
3. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve thirret të paktën një herë në vit.
4. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
5. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktivet e shoqërisë të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 21 MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori dhe/ose nga ortakut/ortakët nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 22 KËRKESA NGA ORTAKET E PAKICË

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e

çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës

NENI 23 PËRFAQËSIMI NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME

1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 24 KUORUMI

1. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë **shumicë të kualifikuar**, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një **shumicë të zakonshme**, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 dhe/ose pikën 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
4. Deris sa shoqëri të jetë me një ortak këto vendime merren nga ortakut i vetëm sipa dispotave të këtij statuti si dhe sipas kërkesave ligjore në fuqi

NENI 25 MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (**shumica e kualifikuar**) për çështjet e përcaktuara në nenin 19, shkronja “b”, shkronja “c”, shkronja “i”, shkronja “j”, shkronja “l”, shkronja “m”, shkronja “o” si dhe shkronja “p”.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve (**shumica e zakonshme**) pjesëmarrës për të gjithë çështjet e tjera të përcaktuara në nenin 20 të këtij statuti.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
4. Përcaktimet e pikës 1 deri tek pika 3 e këtij neni do të zbatohen kur shoqëria do të bëhet me më shumë se një ortak, deriatëhere vendimet merren nga ortaku i vetëm.

NENI 26 E DREJTA E VOTËS

1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.
3. Lejohet pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
4. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
5. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
 - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
6. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 27 PROCESVERBALI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal me numër dhe datë dhe/ose në format elektronik, kur shoqëria të bëhet me më shumë se një ortak.
2. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Procesverbalit duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
4. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
5. Procesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 28 ADMINISTRIMI

Shoqëria **“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.** administrohet nga administratori **Z. Servet Gjaberi** lindur me **08.12.1974**, lindur ne **Kamez dhe banues ne Rruga"Banka Boterore"**, **Lagje nr.4 Bathore, Bashkia Kamez**, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, **Nr. Personal H41208071B.**

1. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
3. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
4. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.
5. Administratori emerohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pese) vjecare, me të drejtë rizgjedhje. Kontrata e punës së administratorit duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
6. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë statut:
 - h) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - i) përfaqëson shoqërinë tregtare;
 - j) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - k) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - l) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - m) kryejn regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - n) raportojn përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
7. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
8. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të stautit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.
9. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
10. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
11. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të

besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

12. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji.

NENI 29 PËRFAQËSIMI

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare” i ndryshuar.
2. Administratoriët, që përfaqësonjnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
3. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.
4. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
5. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
6. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
7. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. numrin unik të identifikimit;
 - b. formën ligjore të shoqërisë;
 - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - e. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 30 DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 28 dhe 29 të këtij statuti, administratori/ët detyrohet/n:
 - a. të kryejnë detyrat të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

- e) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
 - f) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori/ët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori/ët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

KREU IV VITI FINANCAR DHE EKSPERTI NENI 31 VITI USHTRIMOR, LLOGARI VJETORE

1. Cdo vit ushtrimor fillon në datën 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor.
2. Llogarite vjetore, inventari dhe të dhënat mbi lëvizjet financiare të vitit, raportet speciale të ndërtuara nga administrator dhe ekspert kontabël, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Miratimi i dokumentave mbi aktivitetin vjetor kryhen brenda një afati 6-mujore nga data e mbylljes së vitit ushtrimor.
4. Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe evidencës së të ardhurave Asambleja e Përgjithshme vendos pjesën që ju takon ortakëve në formën e dividend në të ardhura.
5. Të ardhurat që ndahen mes ortakëve në bazë të pjesëve në kapitalin themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit ushtrimor.

NENI 32 EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR

1. Në rast nevoje ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga eksperti kontabël i autorizuar dhe zgjedhur sipas ligjit në fuqi dhe statutit të kësaj shoqërie.
2. Eksperti kontabël emërohet çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.
3. Eksperti kontabël mund të shkarkohet më përpara se afati i emerimit të tij, siç parashikohet në pikën dy të këtij neni nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.
4. Eksperti kontabel është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore dhe/ ose rregulloret në fuqi.

KREU V PRISHJA, LIKUIDIMI DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 33 SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

1. Shoqëria priset:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo ne rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i pareali-zueshem për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) në rastet e pavlefshmerise së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit “për shoqëritë tregtare” i dnryshuar
 - e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - f) për cdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

2. Prishja e shoqërise, si pasojë e një apo me shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "e" dhe "f", të pikës 1 të këtij neni, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve me shumicën e cilësuar përcaktuar në këtë statut.
3. Në rast mosveprimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara pikën 2 të këtij neni, cdo person i interesuar mund në cdo kohë t'i drejtohet gjykatës kompetente për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
7. Administratori/ët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

NENI 34 LIKUJDIMI DHE FALIMENTIMI

1. Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
2. Falimentimi i shoqërisë bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij statuti, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjit Nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin" i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

NENI 35 RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Riorganizimi i shoqërisë mund të kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me përcaktimet e këtij statuti si dhe me dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim.

NENI 36 MOSMARRËVESHJET

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë kohës së likuidimit mes ortakëve, mes shoqërive dhe ortakëve fillimisht duhet të diskutohen për gjetjen

e zgjidhjeve me mirëkuptim. Për zgjidhjen me mirëkuptim palët mund të hartojne një akt-marrëveshje midis tyre.

2. Palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund ti drejtohen edhe ‘Ndërmjetësve Ligjore’ të licencuar në përputhje me ligjin në fuqi.
3. Në rast se palët nuk gjejne zgjidhje për mosmarrveshjen e tyre sipas pikave të mësipërme atëhere ato mund ti drejtohen gjykave kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

ORTAKU I SHOQËRISË

“Gjaberi 2001 construction” Sh.p.k.

Z.Servet Gjaberi